



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

**SHPLLJE PËR EKSPERT/KËSHILLTAR
SHKRUES LIBRI DHE SKENARIST PËR FËMIJË**

**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit
Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar**

Në mbështetje të Ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (i ndryshuar), Neni 36, pika 6 “Autoriteti për realizimin e veprimtarisë sipas këtij ligji, ka të drejtë të përzgjedhë dhe të kontrakttojë ekspertë të jashtëm”, të Vendimit të Autoritetit për Informim me nr. 424 datë 27/09/2022, me objekt “Për procedurën që do të ndiqet për kontraktimin e ekspertëve/këshilltarëve vendas apo ndërkombëtarë në bazë të ligjit 45/2015, i ndryshuar”, si dhe VKM nr. 187, datë 8.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”,

shpall Procedurat për kontraktimin e ekspertëve/këshilltarëve në fushën: Shkrues Libri për Fëmijë dhe Skenarist për Fëmijë:

Kategoria e pagës II-b.

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

05/04/2023

1- Detyrat dhe përgjegjësitë:

I mbështetur nga ekipi i Autoritetit, ekspertët këshillues duhet të kryejnë këto detyra:

A) Shkrimtari i librit/kritere mbi librin

1. Për shkrimin e një libri apo skenari për fëmijë, duhet të mbahen parasysh disa kritere të rëndësishme:

- *Gjuha e përshtatshme për moshën:* Librat për fëmijë duhet të përdorin gjuhë që është e përshtatshme për grupmoshën që synojnë. Struktura e fjalorit dhe e fjalisë duhet të jetë e thjeshtë dhe e lehtë për t'u kuptuar, por edhe mjaft e larmishme për të mbajtur vëmendjen e fëmijës.
- *Personazhe tërheqëse:* Libri duhet të përmbajjë personazhe të lidhur dhe tërheqës me të cilët fëmijët mund të identifikohen. Personazhet duhet të jenë të përshkruar mirë, me pika të forta dhe të dobëta, dhe me të gjitha ndryshimet e jetës gjatë rrjedhës së tregimit.
- *Struktura e qartë e tregimit:* Librat për fëmijë duhet të kenë një fillim, vazhdim dhe mbyllje të qartë. Historia duhet të jetë e lehtë për t'u ndjekur dhe jo tepër e ndërlikuar.
- *Ilustrimet:* Libri të ilustrohet me foto, skica të një cilësie të lartë, me ngjyra dhe tërheqëse.
- *Mesazhe pozitive:* Libri duhet të përcjellë mesazhe dhe vlera pozitive, si miqësia, ndershmëria dhe guximi. Gjithashtu duhet të promovojnë diversitetin dhe përfshirjen.
- *Lexueshmëria:* Libri duhet të jetë i lehtë për t'u lexuar me zë të lartë, me tekst ritmik ose me rimë që e bën argëtues kur një i rriturit e lexon për fëmijët.

B) Skenaristi për fëmijë/kritere

- Të jetë në gjendje të krijojë imazhe të gjalla dhe skena përshkruese, në bazë të grup moshës që i takon dokumentari, duke i lejuar audiencës të imagjinojë skenat dhe mjediset;
- Të vendosë në qendër personazhet e intervistuar duke u përqëndruar në mesazhet e tyre;
- Të fokusohet tek pikat kyçe të dëshmisë që dokumentari të jetë sa më tërheqës dhe mbresëlënës për fëmijët.
- Të intervistuarave t'u marrë një detaj, që i karakterizon për t'u bërë më tërheqës për fëmijët;
- Skenari duhet të jetë i prekshëm e t'u drejtojë imagjinatën fëmijëve drejt një kohe që nuk e kanë jetuar;
- Skenaristi duhet të jetë në gjendje të punojë në mënyrë efektive me anëtarët e tjerë të ekipit të prodhimit, duke përfshirë regjisorët, producentët dhe shkrimtarët e tjerë, për të siguruar që ky skenar të lërë mbresa, të nxjerrë mesazhin e duhur që historia të mos përsëritet, e me mesazhin e tij t'i rezistojë kohës.

Target grupet;

- Nxënës të shkollave elementare;
- Nxënës të arsimit parauniversitar;
- Të kryejë detyra të tjera të kërkuara nga Kryetari/ja e Autoritetit.

Rezultatet e pritshme

Shkruesi i librit raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë pranë Drejtorisë së Mbështetjes Shkencor dhe Edukimit Qytetar deri në përfundim të kontratës.

- Draftim i metodologjisë së analizimit të njohjes së historisë nga të rinjtë, lidhur me burgun dhe revoltën e Spaçit;
- Dokument i zhvillimit dhe zbatimit të analizës;
- Pyetësorë, intervista me nxënës, mësues, drejtues të arsimit parauniversitar lidhur me njohjen e së shkuarës së vendit, me fokus burgun dhe revoltën e Spaçit;
- Mbledhja e materialeve vizuale për ilustrimin e ngjarjes;
- Libri

Rezultatet	Data e përfundimit
Material me metodologjinë e analizës	14.04.2023
Tryeza e diskutimeve	17.04.2023
Dokument i zbatimit-gjetjet paraprake	08.05.2023
Draft i pyetësorëve për intervista	08.05.2023
Drafti finali i librit	16.05.2023
Draft-skenari final	16.05.2023
Raport mbi punën e kryer për projektin	20.06.2023
Libri i shkruar final	20.07.2023
Skenari i përfunduar	20.07.2023

**Afatet e mësipërme janë të përafërta dhe aktivitetet apo dokumentet do të realizohen/dorëzohen rreth këtyre datave.*

Për pozicionin, kandidati i interesuar duhet:

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master” në fushën e gjuhë-letërsisë, gazetarisë, (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- Të ketë në portofolin e tij të publikimeve, botime për fëmijë të moshave të ndryshme; (për libërshkruesin);
- Të ketë përvojë të gjatë dhe të evidentuar në drejtim të shkrimit të skenarëve për fëmijë; (për skenaristin);
- Të ketë njohuri të thelluara në historinë e së shkuarës së vendit nën diktaturë, si dhe mbi totalitarizmin në përgjithësi;

- Të plotësojë kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 12 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”

*Në të gjitha rastet, do të prevalojë të pasurit e një përvoje të gjerë në shkrimin e teksteve, skenarëve për dokumentarë, filma për fëmijë

Shtuar kritereve me lart, personi i interesuar duhet të ketë integritet dhe motivim për çështje që lidhen me informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi të shkuarën komuniste në Shqipëri.

2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur;
- b- Jetëshkrim i plotësuar;
- c- Fotokopje të diplomës së masterit;
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 05/04/2023.

3. NJOHURITË MBI LEGJISLACIONIN TË CILAT DUHET TË KETË KANDIDATI:

Njohuritë mbi legjislacionin të cilat duhet të ketë kandidati:

- a) Njohuri mbi Ligjin Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”;
- b) Njohuri mbi Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar;
- c) Njohuri Mbi Ligjin Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;

- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- g) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- h) Njohuri mbi Ligjin Nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”,

4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur proçesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Autoritetit, <http://autoritetidosjeve.gov.al/>. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.